



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

2926
Nr. ___ prot.

Roskovec, më 22.09.2024

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE
PËR POZICIONIN**

**“KRYEINSPEKTOR I INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT”
BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 64 , gërma “g” ; në Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës së Bashkisë Roskovec si dhe Njësive Administrative në varësi Kuman, Strum, Kurjan” si dhe në Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 2, Datë 05.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitet Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum si dhe organigramës për vitin 2024”; ligj nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme i ndryshuar”,

Bashkia Roskovec shpall vendin e lirë të punës “Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Teritorit”,

Afati i fundit i paraqitjes së aplikantëve është më datë 07.09.2024

Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të “Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit” janë,

1. Të organizojë dhe drejtojë të gjithë veprimtarinë e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Roskovec dhe Njësitet Administrative, për të cilën raporton tek Kryetari i Bashkisë”
2. Nënshkruan aktet që dalin nga IMT-ja dhe kërkon nga vartësit ndjekjen për zbatimin e tyre;
3. Ndjek zbatimin e detyrave që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e IMT-së;
4. Shqyrton dhe merr vendime për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit;
5. Vendos masa administrative në ngarkim të subjekteve që shkelin ligjshmërinë në fushën e ndërtimit, siç parashikohet në aktet ligjore në fuqi.

6. Vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimit ligjor.
7. Përgatit kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
8. Vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
9. Në zbatim të detyrimeve ligjore kërkon zyrtarisht mbështetjen e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, për zbatimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme;
10. Jep informacion në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektoriatit.
11. Kërkon për verifikim nga arkivi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dokumentacionin mbi subjektet e ndërtimit që janë në procedura verifikimi për shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit.

B. Kriteret e punësimit të “Kryeinspektor I Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit” janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë diplomë Master Shkencor në fushat e drejtësisë dhe në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin E Ndërtimit” (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij
- Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit”
- VKM 408, DATË 13.5.2015 “Për Miratimin E Rregullores Së Zhvillimit *Të Territorit”, të Ndryshuar
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”,
- Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”

C. Dokumentat që duhet të dorëzojnë të interesuarit, janë si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim,
- Curriculum Vitae,
- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe listës së notave ;
- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);

- Vërtetim për eksperiencën e mëparshme të punës.

Dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet në protokoll, me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike – Bashkia Roskovec, brenda datës 07.05.2024.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës 10.05.2024, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike në Bashkinë Roskovec do të shpallë në web zyrtar të bashkisë dhe në stendat pranë Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së punësimit do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike të Bashkisë Roskovec, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike në Bashkinë Roskovec do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

KRYETAR
Majlinda Bufi

